Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/563
Datë: 05.08.2025

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2025 merr:

VENDIM

I. **Riakreditohet**, "Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë (APPK)". Adresa: Rr. Rexhep Krasniqi, nr.59, 10000 në Prishtinë, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data: 01.08.2025 deri 31.08.2030, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar kualifikimin:

1. **Kurse të Gjuhës Gjermane (A1 – B2)** - APPK mund të realizojë procesin sipas të dhënave në vijim: APPK për të realizuar procesin e aftësimit ka të angazhuar gjithsej gjashtë 6 mësimdhënës të gjuhës gjermane të cilët janë të kualifikuar dhe me përvojë në fushën e mësimdhënies e gjuhës gjermane të cilët janë të kualifikuar dhe me përvojë në fushën e mësimdhënies së gjuhës gjermane. Bazuar në planifikimin aktual të aftësimit gjuhësor kapacitetet vjetore janë si në vijim: numri i kandidatëve për grup: nga dymbëdhjetë (12) deri në gjashtëmbëdhjetë (16) pjesëmarrës. Numri i grupeve që realizohen brenda një viti: 30 deri në 35 grupe.
   Kuota e kandidatëve në baza vjetore vlenë për të gjitha nivelet gjuhësore (A1 – B2) brenda periudhës së akredtimit.

II. Obligohet Institucioni të plotësojë kushtet bazuar në vendimet e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së, "Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë (APPK)", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e APPK, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për rivalidim të kualifikimeve, aplikacionet për riakreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij akti administrativ pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 20, të Udhëzimit Administrativ të MASHT me Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa i drejtohet organit vendimmarrës KD-së së AKK-së, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të njoftimit për vendimin.*

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, , "Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë **APPK**" dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve